



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
ismail rushiti	13.04.2024	24.04.2024	2024/0309

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 08.04.2024, OE “EJONA” SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0309, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Insatlimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestren Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq” me nr. të prokurimit: "635-23-5904-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **590,870.72 €**.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0579 i dt: 25.10.2023 dhe vendimi Nr. 2023/0927 i dt: 12/01/2024.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

-Neni 97

Shkeljet e rënda

97.1 Shkelje të rënda konsiderohen:

h. Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së.

p. Mosrespektimi i afateve kohore në nxjerrjen e vendimit në kërkesa për rishqyrtim dhe afateve

kohore në rast të ankesave në OSHP.

-Neni 39

Krijimi i Komisioneve Vlerësuese të Tenderëve:

39.5 Numri i anëtarëve të komisionit vlerësues do të varet nga vlera dhe kompleksiteti i aktivitetit të

prokurimit, por në të gjitha rastet do të përbëhet nga jo më pak se (3) tre dhe numri gjithnjë do të

jetë tek. **Komisioni do të përbëhet nga anëtar me aftësi të duhura, njohuri dhe përvojë, relevante me**

kërkesat e prokurimit. Njëri nga anëtarët e komisionit shërben edhe si kryetarë i komisionit

39.9 AK ka të drejtë të angazhojë ekspert të jashtëm, në rastet kur kërkohet njohuri dhe ekspertizë e

veçantë teknike ose e specializuar varësisht nga objekti i prokurimit dhe që ekspertë të tillë nuk janë

në dispozicion brenda AK. Ekspertët e tillë i nënshtrohen dispozitave të nenit 11 të LPP-se njëjtë si

anëtarët e komisionit të vlerësimit nga AK.

-UDHËZUESIN Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Asnjë specifikim nuk do të lëshohet me referencë ndaj një marke të caktuar tregtare, emër të brendit,

patentë, dizajn, lloj, origjinë specifike, prodhues, montues, katalog ose artikull me numër.

Kur nuk ka

mënyrë tjetër precize ose të përshtatshme për karakterizimin e kërkesave përveç referencës,

përshkrimi do të përdorët, pasuar nga fjalët “ose të barasvlershme”

-Neni 59

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve

Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi

vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme

kohore dhe jo

më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në

veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë

prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit

të hapjes së tenderëve.

-Neni 28

Specifikimet teknike

-Neni 43

Ndërprerja e procedurave të prokurimit

AK ka bere shkelje te rende duke mos respektuar vendimin e OSHP-se dhe duke tentuar qe perseri ta anuloje aktivitetin e prokurimit me pretendimet e njejta.

AK me daten 04.03.2024 (afer 3 muaj pas vendimit te OSHP-se) na dergon nje Kerkese per sqarimin e tenderit me te njejtat pretendime te cilat jane shqyrtuar 2 here ne OSHP.

Pra kerkon sqarime per diplomat e teknikeve dhe per kapacitetin e chilerit ani pse per keto dy pretendime ekzistojne 2 vendime te OSHP-se ku pretendimet tona jane llogaritur

plotesisht te bazuara.

Edhe pas ofrimit te sqarimeve tona, duke i ofruar perseri informata shtese dhe duke ia rikujtuar AK se per keto pretendime jane 2 vendime te OSHP-se, AK vendose qe me

daten 21.03.2024 (gati 4 muaj pas vendimit te OSHP-se), perseri te anuloje aktivitetin e prokurimit me te njejtat pretendime.

Pra, AK nuk ka respektuar as vendimin e OSHP-se, por as afatet e cekura ne LPP. AK nuk e kthen lende fare ne rivleresim ne afatin kohor te caktuar, mirepo vazhdon me perseri me

Anulim te Aktivitetit te Prokurimit.

Andaj, 2.16. Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i

kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata".

Ndersa, pasi qe kjo eshte hera e 3-te qe AK merr vendime ne kundersiztim me LPP si dhe OSHP-se, besojme se OSHP duhet te marre masa dhe ta vleresoje kete Shkelje si shkelje

te rende kunder veprimeve tendencioze te AK. Te cilet pas cdo vendimi te OSHP-se, vazhdojne me cdo kusht te veprojne vetem per te mos n shperblyer me kontrate.

Po e citojme vendimin e fundit te OSHP-se sa i perket pretendimeve tona ankimore:

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes

profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues

nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes

së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të

provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të

zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e

lëndës ka gjetur se ankesat duhet të aprovohen si te bazuara.

Edhe pse kjo qeshtje tashme eshte shqyrtuar, ne perseri po i bashkangjesim provat

tona se oferta jone eshte e pergjegjshme si nga ana teknike poashtu edhe ajo

profesionale.

Bazuar në vendimin e AK të datës 21.03.2024 dhe komisionit të Rivlersimit argumentet tona janë si në vazhdim:

-Pretendimi 2.

Rivlersimin e tenderit për këtë aktivitet e ka kry një komision i fushës jo-makinerike nga ku edhe kanë krijuar raport jo-profesional, tendencioz dhe qesharak. Ketu zyrtari prokurimit ka shkelë nenin Neni 39 Krijimi i Komisioneve Vlerësuese të Tenderëve:

AK dhe Komisioni i Rivlersimit (i cili sic shihet asnjëri nga ta nuk janë të fushës makinerike dhe atë e deshmon edhe raporti i tyre joprofesional) si në vazhdim:

O.E: " EJONA " SH.P.K.

Gjate Ri- vlersimit te ofertes se juaj nga komisioni i Ri –vlersimit me daten 04.03.2024 kemi derguar Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit dhe me daten 08.03.2024 keni derguar pergjegje dhe lidhur me sqarimet e kerkuara, por ne si AK me komisionin e ri-vlersimit kemi shiqur me kujdes pergjegjet tuaja dhe analizat e bera lidhur me katalogjet si ne vijim:

Te specifikimi teknik ne FDT te pozicioni C.1 eshte kerkuar si me posht


_Pompa Termike Ajër / Ujë (chiler) Me kondenzator te ajrit me ventilator aksial, ftohje dhe ngrohje.I parapare për montim te jashtëm,mediumi punues freon R 410A. HFR-130W/A2F Kapaciteti ftohës: 130 kW Kapaciteti ngrohës: 140 kW Furnizimi me energji elektrike: AC 3R, 380V/50Hz Tubacionet: R 65 mm, Dimensionet L,W,H:

2300x1100x2200 mm Pesha neto: 1030 kg

Ndersa ju ne oferten e juaj keni prezantuar Katalogun e brendit MIDEA ku keni thene qe jane ne perputhje me ato te specifikimit teknik perkatesisht pozicionit C.1 , ndersa komisioni ri-vlersues pas analizes se bere te katalogjeve te prezantuara ka dal ne konstatim se nuk jane ne perputhje me specifikat e kerkuara nga AK ne FDT

Pasi qe (Kapaciteti ngrohës: eshte kerkuar 140 kW) ndersa katalogu i brendit MIDEA tregon se Kapaciteti ngrohës: eshte 138 kW nuk jep me shum se 138 kw, po ashtu te dimensionet e kerkuara ne SPECIFIKIM TEKNIK eshte 2300x1100x2200 mm , ndersa ne katalogun e MIDEA eshte 2200x1120x2060 , qe nuk perputhet me ato te SPECIFIKIMIT TEKNIK per me shum mund te shifni edhe foto deshmin dhe katalogun e produktit:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “EJONA” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Insatlimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestren Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq” me numër të prokurimit: “635-23-5904-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES



Kundërshtimi ynë është si në vazhdim: Fillimisht theksojmë qe kjo pikë është ngritur disa here radhazi, dhe per kete pike tashme i keni 2 vendime te OSHP-se. Mirepo, perseri he bazuar në paramasen tuaj per pozicionin C1 keni kerkuar tipi e chillerit HFR-130W/A2F te tipit HISENSE kerkohet fuqija (130/140) kw,dhe ju si AK beni krahasimin e produkteve tona me nje prodhues te vecante ne kundrshtim me LPP.

UDHËZUESIN Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK nenkupton Asnjë specifikim nuk do të lëshohet me referencë ndaj një marke të caktuar tregtare, emër të brendit, patentë, dizajn, lloj, origjinë specifike, prodhues, montues, katalog ose artikull me numër. Kur nuk ka mënyrë tjetër precize ose të përshtatshme për karakterizimin e kërkesave përveç referencës, përshkrimi do të përdorët, pasuar nga fjalët “ose të barasvlershme” , ndersa AK kembengul qe produktet e ofertuara te jene 100% te njejta me ato qe i jane referuar ne DT. - Duke shkelur keshtu Neni 28 Specifikimet teknike , piken 6,7 dhe 9.

Ne kemi prezentuar ne katalogun tone te prodhuesit ekujvalent MIDEA fuqite (130/138) kw qe eshte e paperfillshme ne kete rast per fuqine e chillerit 140 kw dhe ne tabelen ne vazhdim shihet qe kjo fuqi eshte relative varesisht nge temperaturat e ambientit dhe per temperature te caktuar te ambientit e tejkalon kete vlere.

Si deshmi per kete ne vazhdim prezentojme diagramin e punes per chillerin te cilin varesisht nga temperaturat e ambientit dhe temperaturat e ujit keto kapacitete levizin dhe

per temperature e ambientit 7C kapaciteti i chillerit te prezentuar eshte 141.47 Kw i cili e tejkalon ate te prezentuar.

PER TE TRETEN HERE, BASHKANGJITUR GJENI KATALOGUN E PRODHUESIT
KU DESHMOHET SE PRODUKTI I OFERTUAR I PERMBUSH TE GJITHA

KERKESAT E AK.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “EJONA” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Insatlimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestren Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq” me numër të prokurimit: “635-23-5904-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

Midea												
Heating												
Chilled water outlet (°C)	Model	Ambient temp (°C)										
		-10		-8		-2		2		7		A
		Capacity kW	Power kW	Capacity kW	Power kW	Capacity kW	Power kW	Capacity kW	Power kW	Capacity kW	Power kW	
40	35kW	22.95	7.97	28.89	8.03	33.75	8.93	37.51	9.79	48.77	19.21	42
	65kW	42.88	13.45	53.51	15.39	62.95	16.99	69.94	18.46	76.02	19.43	80
	80kW	52.73	16.58	65.91	18.84	77.55	20.94	86.16	22.78	93.65	23.95	100
	130kW	85.81	26.91	107.61	30.57	125.96	33.97	139.89	36.93	152.05	38.87	157
41	35kW	22.23	7.21	27.82	8.29	32.78	9.11	36.44	9.90	38.68	10.42	44
	65kW	41.45	13.73	51.87	15.60	61.10	17.33	67.06	18.84	73.95	19.83	82
	80kW	51.06	16.92	63.90	19.23	75.27	21.36	83.72	23.22	91.10	24.44	100
	130kW	82.89	27.45	103.75	31.20	122.20	34.68	135.83	37.68	147.91	39.66	160
42	35kW	21.58	7.36	27.05	8.37	31.89	9.30	35.62	10.19	38.69	10.64	43
	65kW	40.25	14.51	50.44	15.92	59.48	17.69	66.23	19.22	72.15	20.24	80
	80kW	49.58	17.26	62.13	19.62	72.37	21.80	81.58	23.69	88.88	24.94	99
	130kW	80.58	28.01	100.87	31.83	118.96	35.37	132.47	38.45	144.30	40.47	161
43	35kW	21.06	7.51	26.43	8.54	31.28	9.49	34.78	10.31	37.93	10.85	42
	65kW	38.28	14.29	49.28	16.24	58.18	18.85	64.86	19.62	70.74	20.65	78
	80kW	48.38	17.62	60.71	20.02	71.68	22.24	79.91	24.18	87.14	25.45	97
	130kW	78.55	28.59	98.56	32.48	116.37	36.89	129.73	39.23	141.47	41.30	153
44	35kW	20.65	7.67	25.95	8.71	30.67	9.68	34.33	10.52	37.37	11.07	41
	65kW	38.52	14.58	49.39	16.57	57.20	18.42	63.84	20.02	69.69	21.07	77
	80kW	47.45	17.88	59.81	20.43	70.46	22.70	78.64	24.67	85.85	25.97	95
	130kW	77.03	29.17	96.78	33.15	114.39	36.83	127.67	40.03	139.38	42.14	134
45	35kW	20.35	7.82	25.60	8.89	30.30	9.88	33.88	10.74	37.00	11.30	41
	65kW	37.96	14.88	47.75	16.91	56.51	18.79	63.14	20.43	68.08	21.50	76
	80kW	46.76	18.34	58.82	20.84	69.61	23.16	77.79	25.18	85.00	26.50	94
	130kW	75.82	29.76	95.49	33.82	113.01	37.58	126.27	40.85	138.00	43.00	153
46	35kW	19.86	7.90	25.13	8.88	29.78	9.97	33.31	10.84	36.45	11.41	40
	65kW	37.22	15.03	46.87	17.08	55.54	18.88	62.12	20.63	67.87	21.72	75
	80kW	45.85	18.53	57.74	21.09	68.41	23.39	76.52	25.43	83.73	26.77	92
	130kW	74.43	30.06	93.74	34.16	111.07	37.98	124.24	41.28	135.93	43.43	150
47	35kW	19.37	8.06	24.42	9.16	29.87	10.17	33.44	11.06	35.53	11.84	39
	65kW	36.12	15.33	45.54	17.42	54.03	19.38	60.90	21.04	66.27	22.15	73
	80kW	44.89	18.90	56.11	21.47	66.56	23.86	74.53	25.94	81.63	27.30	90
	130kW	72.33	30.88	91.89	34.85	108.05	38.72	121.00	42.08	132.53	44.33	148
48	35kW	18.80	8.30	23.49	9.43	27.80	10.48	31.27	11.39	34.29	11.99	37
	65kW	34.69	15.79	43.80	17.85	52.02	19.94	58.32	21.67	63.95	22.81	70
	80kW	42.74	19.46	53.96	22.12	64.08	24.58	71.84	26.71	78.77	28.12	86
	130kW	69.58	31.58	87.60	35.88	104.04	39.68	116.64	43.35	127.89	45.63	141
49	35kW	17.59	8.63	22.24	9.81	26.44	10.90	29.88	11.85	32.58	12.47	35
	65kW	32.80	16.42	41.47	18.68	49.31	20.74	55.34	22.84	60.75	23.73	68
	80kW	40.41	20.34	51.08	23.00	60.74	25.58	68.18	27.78	74.84	29.24	82
	130kW	65.81	32.85	82.94	37.33	99.82	41.47	110.69	45.88	121.50	47.45	133
50	35kW	18.48	9.08	23.83	10.30	24.80	11.44	27.87	12.44	30.62	13.69	33
	65kW	30.69	17.24	38.85	19.60	46.25	21.77	51.96	23.87	57.10	24.91	62
	80kW	37.81	21.26	47.86	24.15	56.97	26.84	64.81	29.17	70.35	30.71	77

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “EJONA” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Insatlimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestren Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq” me numër të prokurimit: “635-23-5904-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

Pretendimi 3.Komisioni i Rivlersimit argumenton si në vazhdim:

Te specififikimit teknik perketesisht pozicionit D.1 , eshte kerkuar

Rekuperator VENTAS ose ekuivalent VHRV RD 8000
Vlera e ajrit për njësi të kohës: 8000 m³/h me këmbyes të nehtësisë me kapacitet Gng=41 kW
Presioni i joshitës statik: 120 [Pa]
Furnizimi me energji elektrike: 230 Volt/50 Hz/1-
Energjia elektrike në hyrje: 4 x 750 [Watt]
Gjerësia: 2200 [mm]
Gjerësia: 2020 [mm]
Lartësia: 640 [mm]
Diametri i lidhjes së kanalit: 305 x 795 [mm]
Pesha: 360 kg
Niveli i zhurmës: 55.5 db(A)

Ndërsa ju ne oferten e juaj keni prezantuar Katalogun e brendit MIDEA ka keni thënë që janë në përputhje me ato të specifikimit teknik perketesisht pozicionit D.1 , ndërsa komisioni rivlersimit pas analizës së bërë të katalogeve të prezantuar ka dalë në konstatim se nuk janë në përputhje me specifikat e kërkuara nga AK

Pasi që edhe kërkuara që Gjerësia të jetë: 2200 [mm], Gjerësia të jetë: 2020 [mm] si dhe Lartësia: 640 [mm], ndërsa ju ne katalogun e paraqitur ne oferten e juaj respektivisht [faqja 1/2](#) dhe [2/2](#) nuk përputhen me ajera tjetërta pasi që ne faqen 1/2 keni prezantuar dimensionat të ndryshme me ato të faqes 2/2 që nuk janë në përputhje me ajera tjetërta ku me shuma mund të shihet edhe foto desheut.



Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “EJONA” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Insatlimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestren Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq” me numër të prokurimit: “635-23-5904-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

P-2-D1



Customer name:

Project name: Page 2

Create date: 21.06.2023

Order no:

Page: 2/5

Print on date: 21.06.2023

Software version: Fanit V.A.2.0.0

Release/Rev. Date: 06.10.2023/01.1.2024

Contact person:

Project code:

Rev. date: 03.07.2023

Rev. no:

UNIT INFORMATION	
Supply Air Volume Flow Rate	8,000 [m³/h]
Supply Air Volume Flow Rate	2.22 [m³/s]
Exhaust air volume flow rate	8,000 [m³/h]
Exhaust Air Volume Flow Rate	2.22 [m³/s]
Supply Air Vol. in Ceiling Cassette	4.44 [m³/s]
Exhaust air vol. in ceiling cassette	2.22 [m³/s]
Face velocity on coils	2.6 [m/s]
External sheet	Galvanized - 0.6 mm
External sheet	PVC Galvanized - 0.8 mm
	Insulation material
	Rockwool (50 mm - 70 kg/m³)
	Face Aluminium Profile - 50 mm
	Inner profile
	Face Velocity - 50 mm
	Base
	Galvanized - 1.0 mm
	Panel Thickness
	50 [mm]
Width / Height / Length	2000 x 1830 x 2300 [mm]
Weight	637 [kg]
Quantity	1 [pcs]
Place	
Design Outdoor Temperature	-5.50 [°C]
Design Outdoor Humidity	90 [%]
Air density	1.16 [kg/m³]

	Supply	Exhaust
Face name	Roofline - DC 10-10 - (x2)	Roofline - DC 10-10 - (x2)
Pressure drop total	485	450 [Pa]
Speed	965	965 [rpm]
Motor power	0.75 x 2	0.75 x 2 [kW]

Others	
Heating capacities	E2 - 40-45 [kW]
Cooling capacities	
Fine filters	E3 - G4
Pre filters	E1 - G4
Accessories	None

CITIM I AK:

Ku mund te shihni edhe te Motor power keni prezantuar katalogun me kapacitet 0.75x 2 (kw) ndersa ne specifikim teknik eshte kerkuara qe Energjia elektrike në hyrje: 4 x 750 [Watt](qe i bije te jete 4 x0.75 (kw) qe fuqia e kapacitet eshte pergjysem me ata qe eshte kerkuar ne specifikim teknik.po ashtu te pesha e kerkua ne specifikim teknik eshte Pesha: 360 kg ndersa ju ne katalogun e juaj keni prezantuar peshen prej 637 kg qe nuk eshte ne perputhje me specifikat teknike.

Dhe ju njoftojm se Specifikimi Teknik i prezantuar nga ana juaj nuk perputhet me specifikimet e prezantuara nga ana juaj.

Andaj me keqardhje ju njoftojm se oferta juaj eshte e pa pergjegjeshme dhe ju njoftojm qe ky A.P anulohet

Kundërshtimet tona janë si në vazhdim:


Në specifikimet teknike të DT kërkohet Rekuperatori VENTAS ose ekuivalent VHRV RD

8000,ku të dhenat bazike të këtij rekuperatori janë kapaciteti,mundi,presioni statik dhe jo dimensionet fizike të tij.Pasi asnjëri nga ankeret e komisionit nuk i perket kesaj fushe ndoshta edhe pa qellim nuk i ka verejtë kapacitetin 4x750 wat dhe ne kemi prezentuar 2x(0.75x2) kw,në vazhdim shihen kilovatet e kerkuar me ngjyrë.

Exhaust air vel. in casing cross section	2.22 [m/s]	Base	Galvanised - 120mm	Design Outdoor Humidity	90
Face velocity on coils	2,6 [m/s]	Panel Thickness	50 [mm]	Air density	1,16 [kg]
Fans					
Fan name	Supply		Exhaust		-
	Nicotra - DD 10-10 - (x2)		Nicotra - DD 10-10 - (x2)		
Pressure drop total	488		469 [Pa]		
Speed	985		967 [rpm]		
Motor power	0.75 x 2		0.75 x 2 [kW]		
Others					
Heating capacities	S2 - 40.46				[kW]
Cooling capacities					[kW]

Ku është prezentuarë kapaciteti 4x0.75 (qe janë 4 ventilatorë me 0.75 kw për shkak të kapacitetit të rekuperatorit prej 8000 m3/h -2 ventilatorë thithës dhe 2 ventilatorë prurës). Sa i përket pretendimeve qe ka ndryshim të dimensioneve deklarojmë qe dimensionet e dhena janë nga software i përzgjedhjes së rekupertaorit dhe dimensionet janë sipas vizatimit në vazhdim :

Ndersa ju ne oferten e juaj keni prezantuar Katalogun e brendit MIDEA ku k



Rekuperatori i prezentuarë nuk është Midea por FAN MAK (komisioni deklaroi prodhuesin MIDEA) dhe dimensionet e rekuperatorit janë 2200x2020x640 dhe të njëjtat pastaj ndryshojnë në rast të porosisë të cilat mund të levizin varësisht nga vendi se ku do të montohet, i jashtëm apo i brendshëm, dimensionet e ngrohjes, trashësia e izolimit, etj. Lidhurë me peshën e Rekuperatorit që keni deklaruar që ka levizje nga 360 në 637 sqarojmë komisionin se pesha e rekuperatorit i cili ka qenë në paramasë fillimisht ka disa elemente opcionale të rekuperatorit të kërkuar VHRV 8000 si më poshtë:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “EJONA” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Insatlimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sportive Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestren Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sportive Karagaq” me numër të prokurimit: “635-23-5904-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

VENTASTAR Radial Fan VHRV Models	VHRV RD2000	VHRV RD2500	VHRV RD3000	VHRV RD4000	VHRV RD5000	V
Air Flow [m³/h]	2000	2500	3000	4000	5000	
External Static Pressure [Pa]	155	150	220	220	220	
Heat Recovery Efficiency Value [%]	Depending on operational temperature and conditions, up to 70% efficiency with Klinge					
Power Supply	230 Volt / 50 Hz / 1~					
Input Power [Watt]	2 x 420	2 x 420	2 x 550	2 x 750	4 x 550	
Input Current [Ampere]	2 x 5	2 x 5	2 x 4,9	2 x 7,7	4 x 4,9	
Air Filter	G4-Class Synthetic Fibre Cassette Filters at the entrance of Fresh air					
Optional Accessory	6	9	9	12	18	
Duct Type Electrical Heater [kW]	Ø300	Ø355	Ø355	Ø400	Ø400	
Optional Accessory	9	13,5	13,5	18	27	
Duct Type Heater Hydrous Coil 90/70°C [kW]						
Optional Accessory	15	18	22	30	35	
Duct Type Cooler Hydrous Coil 7/12°C [kW]						
Optional Accessory	15	18	22	30	35	
Duct Type Cooler DX Coil - R410A [kW]						
Length [mm]	1500	1700	1700	1800	2200	
Width [mm]	980	1180	1180	1180	2020	
Height [mm]	420	540	540	540	640	
Duct Connection Diameter [mm]	Ø300	Ø355	Ø355	Ø400	Ø400	
Weight [kg]	90	105	180	180	360	
Service Space [mm]	700	800	800	900	1200	
Noise Level db[A]	52,4	53,6	54,1	54,5	54,7	
D [mm] Duct Connection	Ø300	Ø355	Ø355	Ø400	Ø400	

Dhe të njejtat levizin pastaj varesisht nga opcionet qe zgjedhë,trashesia e

izolimit,trashesia e llamarinës së zinguar dhe faktorë të tjerë.Në tabelë shihet pesha e rekuperatoreve edhe me te vegjel qe kane nga 360 kg gjë qe është gjenerale pastaj në varësi të opcioneve dhe kapaciteteve ndryshon pesha dhe nuk mund te kenë peshën e njëjte rekuperatori 5000 si rekuperatori 8000.Në rastin e rekuperatorit tonë të prezentuar ne kemi përzgjedhë ngrohësin me ujë 41 kw, izolimin e tij Rockwool (50 mm - 70 kg/m3),etj,te cilat te gjitha ndikojnë në peshë por jo në parametrat bazik të tij (prurjen,mundin,kapacitetin e ngrohësit me ujë,etj) dhe kundërshtojmë vlersimin e komisionit.

Pretendimi 4.

Për të argumentuar atë qe theksuam më lartë qe ky komision është joprofesional dhe tendencioz dhe është caktuar me mision të caktuar po ju argumentojme si në vazhdim:

Bazuar në raportin e Rivlersimit të ketij komisioni OE CTA eliminohet VETEM për nje arsye lidhur me deklaraten, mirepo nuk kane vleresuar aspak oferten teknike qe eshte

jashte standardeve te kerkuata nga AK.

Bazuar në keto qe cekem më lartë arrijmë në perfundimin që ky komision i vlersimit nuk i ka as njohurite bazike makinerike gjë qe është normale për inxh të cilët nuk i përkasin kësaj fushe dhe kur kesaj i shtohet edhe detyra qe ka marre parprakisht -kjo është e papranueshme nga ana jonë.

P.S: PER SHKAK TE DOKUMENTEVE TE SHUMTA TE BASHKANGJITURA NE KETE FORME (KATALOGJE), JU LUTEM GJENI TE BASHKANGJITUR FORMEN E ANKESES EDHE NE WORD TEK DOKUMENTET PERCJELLESE NGA KU MUND TE SHIHEN QARTAZI TE GJITHA PROVAT.

PERFUNDIM:

- Per te gjitha keto pretendime, ka 2 vendime te OSHP-se dhe kemi ofruar deshmi te mjaftueshme per te argumentuar oferten tone te pergjegjshme.

Andaj, kerkojme nga OSHP qe te ndaloje keto veprime tendencioze te AK, i cili tash e 10 muaj vazhdon me cdo kusht te gjeje cfare do lloj argumenti vetem qe te mos na shpalle fitues se ketij aktiviteti.

Pra, kerkojme nga OSHP qe te detyroje perseri AK qe te ktheje lenden ne rivleresim si dhe ta shqiptoje verejtjen e duhur sipas LPP.

AK gjate rivleresimit duhet te marre vendimin ne perputhje me LPP, duke mos na detyruar qe lenden e perseritur per te tretien here ta dorezojme edhe ne organe tjera ligjore, me pretendimin e ndikimit te jashteligjshem.

KRITERET PËR VLERËSIM

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “EJONA ” SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Insatlimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestren Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq” me numër të prokurimit: “635-23-5904-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

C Kaldatorja				
Nr.	Emertimi i materialit	Njesia	Sasia	
C.1	_Pompa Termike Ajër / Ujë (chiler) Me kondenzator te ajrit me ventilator aksial, ftohje dhe ngrohje.I parapare për montim te jashtëm,mediumi punues freon R 410A. HFR-130W/A2F Kapaciteti ftohës: 130 kW Kapaciteti ngrohës: 140 kW Furnizimi me energji elektrike: AC 3ø, 380V/50Hz Tubacionet: ø 65 mm, Dimensionet L,W,H: 2300x1100x2200 mm Pesha neto: 1030 kg	set	4	x
D				
D.1	_Rekuperatori VENTAS ose ekuivalent VHRV RD 8000 Vëllimi e ajrit për njësi të kohës: 8000 m³/h me këmbyes të nxehtësisë me kapacitet Qng=41 kW Presioni i jashtëm statik: 120 [Pa] Furnizimi me energji elektrike: 230 Volt/50 Hz/1- Energjia elektrike në hyrje: 4 x 750 [Watt] Gjatësia: 2200 [mm] Gjerësia: 2020 [mm] Lartësia: 640 [mm] Diametri i lidhjes së kanalit: 395 x 795 [mm] Pesha: 360 kg Niveli i zhurmës: 55.5 db[A]	copë	2	x

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "EJONA" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Insatlimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestren Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq" me numër të prokurimit: "635-23-5904-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

LISTA E PLOTË STANDARDE E RADHITJES SË TENDERËVE SIPAS KRITERIT TË DHËNIES

Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

Sipas Nenit 60.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Kjo listë duhet të largohet nga raporti, në qoftë se kriter për dhënien e kontratës është përcaktuar "Tenderi përgjegjës ekonomikisht më i favorshëm".

Nr.	LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestren Karagaq dhe Leshan	Çmimi total i ofertës dhe Pikët Teknike
1.	"CTA" Sh.p.k., 600028816	461.396.18 € (00.00 pikë)
2.	"EJONA" SH.P.K.	388.444.00 € (00.00 pikë)
3.	ALFA.i	428.520.85 € (00.00 pikë)

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

KOMUNA E PEJES ANULON LOT 1 pasi që as një ofert nuk ka qene e pergjegjeshme.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

PSH Nr. 2023/0654

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - "EJONA" SH.P.K.

Sqarim për Panelin Shqyrtues: Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejës, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: "Insatlimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestren Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq", me numër të prokurimit: 635-23-5904-5-1-1,

procedurë e hapur, lloji i kontratës: Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 590,870.72 €.

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë me datën 09.06.2023, Ndërsa, me datë 15.06.2023 dhe 07.07.2023 ka publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve.

AK pas Rivleresimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së me datë 21.03.2024 . Ndersa, OE ankues "EJONA SH.P.K." me datë 26.03.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së kundër Vendimit të AK-së, AK me datë 27.03.2024 ka nxjerrë Vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht kundër këtij Vendimi të AK-së, OE ankues "EJONA SH.P.K." me datë 08.04.2024 , ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit 2024/0309, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, shkresave të lëndës në platformen elektronike e-prokurim i paraqet këto të gjetura si në vijim:

Pretendimet ankimore të OE ankues "EJONA SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Insatlimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq ne Peje LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit ne Palestren Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriqimit ne Palestren e sporteve Karagaq", me numër të prokurimit: 635-23-5904-5-1-1", janë shqyrtuar nga Paneli Shqyrtues, si rrjedhojë lidhur me këtë çështje nga PSH janë nxjerrë dy Vendime:

Vendimi me Nr. 2023/0579 te dates 25.10.2023 dhe

Vendimi me Nr. 2023/0927 te dates 12/01/2024.

Sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues, të paraqitura në ankesen 2024/0309 , meqenëse si arsye për eliminimin nga AK për këtë aktivitet të prokurimit kanë të bejnë me katalogun e ofruar nga OE EJONA SHPK, lidhur me këtë, Eksperti shqyrtues sqaron se:

